



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

SCC-06-0484

A (B) D, D

Kundër

*Paditësi:*

*Të Paditura:*

**K e D.**

**N.SH A**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**,

Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Prishtinë.

**Republika e Serbisë.**

**M i D, D.**

**Z M, D.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj, gjyqtari kryesues, Sylejman Shumolli dhe Hajrie Shala, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 nëntor 2022, lëshon këtë:

## **A K T V E N D I M**

**I. Padia e paditësit, A (B) D, hedhet poshtë si e palejueshme.**

**II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Me 22 nëntor 2006, paditësi parashtrij padi pronësore në Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme (tuje shkurtesa DHPGJS) me të cilën kërkon që të vërtetohet se ai është pronar i ngastrës kadastrale nr.138, në sipërfaqe prej 0.77.79 ha, KK D, apo si alternativ nëse nuk është i mundur kthimi atëherë ti njihet kompensim në të holla në bazë të vlerës së tregut.

Paditësi ka pohuar se paluajtshëmria në fjalë i është konfiskuar paraardhësve të paditësit nga pushteti i atëhershëm në vitin 1948, pa kurrfarë kompensimi apo ndërrimi të saj. Tutje ka theksuar se K e D, me pëlqimin e N.SH-së "A", pronën që pretendohet të jetë e paditësit, i ka dhënë një paraardhësi të paditurit Z M, në shkëmbim për një pronë ku më vonë është ndërtuar Stacioni i autobusëve në D.

Ka shtuar se nuk është ndalur duke kërkuar vendosjen e drejtësisë lidhur me paluajtshëmrimin kontestues, prandaj i është drejtuar Gjykatës K në D, Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe ka bërë njoftim zyrës regjional të AKM-së, në Pejë. Padiësi pohon se atij dhe trashëgimtarëve tjerë me anë të aktgjykimit P.br. 802/94 të Gjykatës Komunale të Pejës të dt. 23 prill 1996, i është njohur e drejta e pronësisë për paluajtshëmrimin kontestuese, por që vendimi nuk është bërë i formës së prerë për shkak të paraqitjes së ankesës.

Padiësi ka kërkuara nga Gjykata edhe caktimin e masës së përkohshme në mënyrë që tu ndalohet të paditurve tjetërsimi i ngastrës nr.138 e cila është objekt i padisë.

Me 16 maj 2007 DHPGJS, ka refuzuar kërkesën e padiësit për caktimin e masës së përkohshme. Vendimi i DHPGJS, për masë të përkohshëm ishte përfundimtar.

Me parashtresën e dt.19 qershor 2007, padiësi i ka dorëzuar gjykatës në kopje: njoftimin nr.5547, të vitit 1957, Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, C.nr.292/69, të dt.26 maj 1972, me të cilin është pranuar në tërsi padia dhe si kompensim për ngastrën nr. 138, i është njohur shuma monetare në vlerë pre 30.000 dinar të atëhershëm, Aktgjykimin e Gjykatës së Lartë të Kosovës, Prishtinë Gzh- nr.423/72, të dt. 01 shkurt 1973, me të cilin ish-in refuzuar ankesat ankuesve dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë nr.292/69, i dt.26 maj 1972, Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë nr.292/69 të dt. 10 maj 1977, me të cilin ishte refuzuar propozimi për përsëritje të procedurës që kishte përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm C.nr.292/69, të dt.26 maj 1972. Aktvendimin i Gjykatës Supreme GZ.nr.565/77 të dt. 15 shkurt 1978, me të cilin ishte refuzuara si e pabazuar ankesa e paraardhësit të padiësit.

Me 29 qershor 2007, Agjenci Kosovare e Mirëbesimit (AKM) ka ushtruar mbrojtje në padi dhe i ka kundërshtuar si të pabazuar të gjitha pretendimet e padiësit të paraqitura në padi. I ka propozuar gjykatës që padinë e padiësit ta hedh poshtë apo ta refuzoj si të pabazuar.

Me 11 korrik 2007, gjykata mbrojtjen e AKM-së e ka dorëzuar për përgjigje tek padiësi.

Me 11 janar 2008, padiësi ka paraqitur një përgjigje ndaj mbrojtjes se AKM-së dhe ka përsëritur pretendimet e tij, duke kërkuar nga gjykata që ti njihet atij e drejta në parcelën nr.138, apo si alternativ nëse nuk është i mundur kthimi atëherë ti njihet kompensimi në të holla.

Edhe me parashtresën e fundit të dt. 14 maj 2021, padiësi kërkon nga Gjykata që ti njihet e drejta e tij lidhur me ngastrën nr.138, KK Deçan.

Me 30 maj 2022, Gjykata ka kërkuara nga padiësi aktvendimin e trashëgimisë.

Me 03 qershor 2022, padiësi dorëzoi aktvendimin e trashëgimisë të dt. 18 shtator 1974 të lëshuara nga Gjykata Komunale në Pejë.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtresave të palëve.

## Arsyetimi ligjor

Padia e paditësit është e palejueshme.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

*Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Neni 391 pika d) e Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore thotë:

Gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se çështja është gjë e gjykuar (res iudicata);

Paditësi me padi por edhe me parashtrësata tjera kërkon nga Gjykata njohjen e të drejtës së pronësisë për ngastrën nr.138, në sipërfaqe prej 0.77.79 ha, KK Deçan, apo si alternativ nëse nuk është i mundur kthimi atëherë ti njihet kompensimi në të holla në bazë të vlerës së tregut.

Gjykata konstaton se me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, C.nr.292/69, të dt.26 maj 1972, i cili është i formës së prerë, është vendosur çështja juridike e cila është objekt i këtij kontesti, pasi që paraardhësit të paditësit i është pranuar në tersi padia për ngastrën kontestuese dhe si kompensim për ngastrën nr. 138, K.K Deçan i është njohur shuma monetare në vlerë prej 30.000 dinar të atëhershëm.

Aktgjykimi në fjalë ishte vërtetuar me Aktgjykimin e Gjykatës së Lartë të Kosovës, Prishtinë Gzh-nr.423/72, të dt.1 shkurt 1973. Gjykata po ashtu vëren se me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë nr.292/69 të dt. 10 maj 1977, ishte refuzuar edhe propozimi për përsëritje të procedurës. Gjithashtu me Aktvendimin e Gjykatës Supreme Gz-nr.565/77 të dt. 15 shkurt 1978, ishte refuzuara si e pabazuar ankesa e paraardhësit të paditësit e paraqitur kundër Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, C.nr.292/69.

Nga këto vendime Gjyqësore të lartcekura konstatohet qartë se çështja e paditësit është çështje e gjykuar (res iudicata), andaj, Gjykata nuk mundë të lëshoj dy herë aktgjykim për të njëjtin objekt të kontestit, kur tani për atë çështja ekziston aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës së Qarkut në Pejë, C.nr.292/69, i dt.26 maj 1972.

Gjykata nuk e komenton aktgjykimin P.br. 802/94 të Gjykatës Komunale të Pejës të dt. 23 prill 1996, në të cilën thirret paditësi, pasi siç edhe ka pohuar vet paditësi aktgjykimi nuk është i formës së prerë, prandaj sipas gjykatës është jo relevante te jepet çfarëdo arsyetimi në lidhje me aktgjykimin në fjalë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv këtij aktvendimi.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Paditësi ka paguar taksën gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë. Ndërsa në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Hajrie Shala, Gjyqtare